



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim**

Legjislatura e III-të
Nr. 12/08
Prishtinë, më 16.09.2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Sadik Idriz, Numan Balić, Zylfi Merxha, Xhevdet Neziraj, Zafir Berisha, Mursejl Haljilji, Hafize Hajdini, Hetem Arifi.

Anëtarët jo të pranishëm: Kosara Nikolić, Enis Kervan.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Maria Fihl Vetting nga ICO, Mimoza Jupa nga Ambasada Amerikane, moniturores nga Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Tisma-Prica, Arta Hajra, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e 22 korrikut 2008.**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**
Të ftuar: Përfaqësues nga Zyra e EULEX-it në Kosovë;
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-056 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet tjera me raportin e komisionit funksional - Komisioni për**

- Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-042/1 të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;**
 - 6. Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e dt. 22 korrikut 2008

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 22 korrik 2008, u miratuan pa vërejtje.

- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**
Të ftuar: Përfaqësues nga Zyra e EULEX-it në Kosovë

Kryesuesi, theksoi se Komisioni ka punuar mjaftë në Projektligjin në fjalë, me qëllim që të miratohet një ligj i zbatueshëm dhe i cili garanton të drejta të barabarta për të gjithë komunitetet. Në këtë drejtim ka krijuar grupin punues, i cili hartuar disa amendamente, për çka edhe i falënderoi. Në ndërkohë, kryetari tha se ka ra në kontakt me përfaqësuesit e ICO/EULEX dhe Ambasada të Amerikane, të cilët kanë ofruar mbështetjen lidhur me këtë Projektligj, gjë që dëshmon edhe prania e tyre në këtë takim. Më pas kryetari ia dha fjalën përfaqësueses së ICO.

Maria Fihl Vetting, duke komentuar Projektligjin, theksoi se përfaqësuesit e ICO, të OSCE-së dhe Këshillit të Europës që kanë përvojë në çështjen pronësore juridike, kanë vërejtje se Projektligjin si i tillë ndikon në të drejtat e komuniteteve në Kosovë. Prandaj problematika duhet diskutuar. Dispozitat e projektligjit janë në konflikt me disa ligje tjera, veçmas me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, pastaj me vendimet e drejtoratit për pronësi dhe banim si dhe me APK-në. Më tutje vazhdoi se Projektligji ka disa paqartësi juridike. Analiza e ndikimit financiar nuk është bërë, nuk është në harmoni me standardet evropiane. Pastaj problematike është çështja e shtetësisë, të drejtat e pronarëve të zhvendosur. Me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të këtij Projektligji, që ai të jetë i zbatueshëm, znj. Vetting propozoi formimin e një grupi punues, të cilin do ta përbënin dy anëtarë nga Komisioni, përfaqësuesit e ICO, EULEX-it, AKP-së, OSCE dhe përfaqësues nga Ambasada Amerikane.

Mimoza Jupa, theksoi se mbështet komentetet dhe propozimet e përfaqësueses së ICO, znj. Vetting.

Kryesuesi, falënderoi përfaqësueset për përkrahjen e ofruar. Në këtë drejtim tha se janë kyçur faktorët relevant të cilët dëshirojnë të ndihmojnë më qëllim të miratimit të një ligji që do të jetë i zbatueshëm për fushën që rregullon. Në vazhdim pyeti nga anëtarët nëse kanë ndonjë propozim.

Numan Balić, njoftoi për punën që ka bërë nënkomisioni dhe amendamentet e hartuara. U pajtua me përfaqësuesen e ICO se Projektligji ka nevojë për rishqyrtim të disa kapitujve e jo vetëm disa neneve. Në veçanti duhet trajtuar dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore, të drejtat e pronarëve të zhvendosur, shtetësinë, përcaktimin e çmimit, vlerës, pronarëve të banesave.

Sadik Idriz, u pajtua me idenë për krijimin e një grupi punues. Por paraprakisht propozoi që Komisioni të mbaj një takim me komisionin funksional në mënyrë që të harmonizohen qëndrimet në mënyrë që të dalim në seancë rekomandimet e pakoordinuara.

Kryesuesi, pyeti përfaqësuesen e ICO nëse kanë menduar të ftojnë në kuadër të grupit punues edhe anëtarët e komisionit funksional.

Maria Fihl Vetting, theksoi se nuk kanë kontaktuar me përfaqësuesit e komisionit funksional, sidoqë të jetë atë mund të përfshihen në grupin punues dhe të jenë pjesë e procesit.

Sanije Aliaj, përshëndeti iniciativën e ICO për të kontribuar me qëllim që të nxjerret një ligj, i cili është aplikueshëm dhe në dobi të të gjithë komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Ky është edhe interesi i Komisionit dhe Kuvendit që të miratojë Ligje që do të jenë të zbatueshme.

Kryesuesi, propozojë që nga dy anëtarët e komisionit për grupin punues, njëri të jetë z. Numan Balic ndërsa për tjetrin të propozohet nga anëtarët e komisionit.

Zylfi Merxha, propozoi Znj. Sanije Aliaj si anëtare të dytë.

Sanije Aliaj, rreth propozimit të saj theksoi se nuk dëshiron të zënë vendin anëtarëve nga nënkomisioni ekzistues, andaj propozoi që edhe anëtari dytë të jetë nga ai nënkomision.

Xhevdet Neziraj, propozoi që grupi punues të jetë gjithëpërfshirës. Të ketë përfaqësues edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, që të bëjnë vlerësimin e implikimit financiar. Duke pasur parasysh zvarritjen e miratimit të këtij Ligji, kërkoi që ky grup të fillojë punën, të propozojë amendamente dhe të miratohet ai.

Mursejl Haljilji, duke ditur përvojën në komision dhe faktin që vjen prej komunitetit shumicë, mbështeti propozimin e znj. Aliaj që të jetë si anëtare e dytë e komisionit për grupin punues.

Numan Balić, propozoi që z. Xhevdet Neziraj, të jetë anëtarë i dytë, pasi që është ekonomist dhe njëkohësisht edhe anëtarë i komisionit për buxhet dhe financa, mund të jep kontribut për implikimet financiare të Projektligjit.

Kryesuesi, duke u ndërlidhur me parafolësin, theksoi se KBF duhet dërgoj dy anëtarë që të jenë pjesë e grupit punues. Pyeti znj. Aliaj se a pranon të jetë anëtare e grupit punues, e cila pranoi.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin të bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

V E N D I M

Caktohen dy anëtarë të komisionit që do të jenë pjesë e grupit gjithëpërfshirës punues, i cili do të bëjë rishqyrtimin e Projektligjit nr.03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore dhe do të propozojë amendamentet në afatin sa më të shkurtër.

Anëtarët e caktuar të komisionit për pjesëmarrje në grupit gjithëpërfshirës punues:

1. **Numan Balić dhe**
2. **Sanije Aliaj**

4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-056 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet tjera me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente**

Sanije Aliaj, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Zëvendës kryesuesja e parë konstatoi se me dhjetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin nr.03/L-056 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet tjera dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
 - II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin e komisionit funksional-Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-042/1 të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**

Sanije Aliaj, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Zëvendës kryesuesja e parë konstatoi se me dhjetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin nr. 03/L-042/1 të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.

6. Të ndryshme

Sanije Aliaj, njoftoi anëtarët për takimin që ka pasur me një përfaqësues të ambasadës zviceriane lidhur me vizitën e premtuar atje. I njoftojë me pyetjet që i ka bërë asaj. Cili është qëllimi i vizitës, cilat institucione kanë dëshirë të vizitohen, a dëshirojnë që komisioni të jetë mix përfaqësues edhe nga qeveria. Përgjigjet kanë qenë se qëllimi vizitës është shkëmbimi përvojave, takimi me institucionet që punojnë me komunitete, e ka njoftuar me punën e komisionit, nuk prish punë që komisioni të jetë i përzier, e rëndësishme të marrin pjesë të gjithë anëtarët. Vizita planifikohet të realizohet në tetor ose nëntor.

Zafir Berisha, propozoi që të vizitohet tre komunitetet që jetojnë atje, që do të mund të merrej si model bashkëjetesës së mirë edhe në Kosovë.

Sanije Aliaj, u pajtua për ngecjen në zbatimin e planit nga komisioni dhe pasivitetin në punë. Rikujtoi kërkesat drejtuar institucioneve për përcjelljen e mbledhjeve të komisionit. Gjithashtu kritikoi për ngecjen në implementimin e planit të punës, sidomos realizimin e vizitave në teren.

Xhevdet Neziraj, për shkak të angazhimeve të kryetarit kërkoi nga nënkryetaret e komisionit të punojnë më shumë që të mund të realizohet kjo vizitë por edhe të tjerat brenda dhe jashtë vendit, ashtu siq janë paraparë me plan.

Numan Balić, gjithësheu kërkoi që nënkryetaret të marrin këtë përgjegjësi për organizimin e vizitës në Zvicër. Ndërsa lidhur me mosrealizimin planit të punës kërkoi që të diskutohet në një mbledhje tjetër.

Zafir Berisha, kërkoi që të ndikohet më shumë në institucionet vendore që të përfilllet puna e këtij komisioni. Në këtë drejtim propozoj që t'iu bëhen rekomandime atyre në mbledhjen e radhës.

Sadik Idriz, mbështeti vërejtjet për pasivitetin e krijuar në punën e këtij komisioni, dhe kërkoi që në një mbledhje të diskutohet si pikë e veçantë, se sa ka punuar komisioni deri më tani.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Bojan STOJANOVIĆ